REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Në baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 2, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008", i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016", e konfor nenit 15 dhe 29, pika 2 dhe 54 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datës ----------, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim bëhet kompensimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale për terë territorin e Komunës së Suharekës, i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Suharekës 01-Nr-020-35235 të datës 29.07.2026.

Neni 2

2.1 Për punën që do ta kryej komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, do të kompensohet nga 50€, për çdo takim që do ta mbajë.

2.2 Kompensimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Anëtaret e komisionit të lartcekur, nuk mund të kompensohen apo paguhen më shumë se 6, (gjashtë) takime.

Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës, përkatësisht Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit
_____
Mr.ec Bexhet KUÇI